



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Temë e diplomës master (në dispozicion)

## **Sistemi mobil për monitorimin e ujit të pijshëm dhe raportimin e rasteve me diare në rajone të përzgjedhura në Kosovë**

**Hyrje:** Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) është institucion shëndetësor që përgadit dhe zbaton strategjinë e shëndetit publik (masat higjieniko – sanitare, masat profilaktiko – kunderepidemike, socialo mjekësore, promovimin e shëndetit, edukimin dhe arsimimin shëndetësor, kontrollën e kualitetit të ujit, ajrit, ushqimit, PZI (programi i zgjeruar i imunizimit), politikën shëndetësore dhe ekonomikën shëndetësore, informimin shëndetësorë) në mbarë territorin e Kosovës. Duke marrë parasysh fushëveprimtarinë e institutit, puna e hulumtuesve aty varet shumë nga të dhënat që duhet të mblidhen, përpunohen dhe vizualizohen në mënyrë të vazhdueshme. Andaj si pjesë e këtij bashkëpunimi, ideja do të jetë të bëhet zgjidhja ideore dhe implementimi fillestar i një sistemi mobil që do mundësonte automatizimin e punës në IKShP si dhe rritjen e eficientës së hulumtuesve të institutit kur kanë të bëjnë me procesimin e të dhënave nga terreni.

**Qëllimi i punimit:** Ky punim do të jetë pjesë e ekipit multidisiplinar të përbërë nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP), si dhe me përkrahje nga Linnaeus University (Suedi) (Lnu). Qëllimi primar i këtij punimi është dizajnimi dhe zhvillimi në nivel të prototipit të sistemit mobil që do të mundësojë grumbullimin e të dhënave, përpunimin e tyre, si dhe zhvillimin e teknikave për vizualizimin dhe raportimin e tyre. Të dhënat e mbledhura do të jenë në formatin që duhet të diskutohet në bashkëpunim me IKShP. Për më shumë, të dhënat duhen të jenë të lokalizuara (*geolocated*). Si pjesë e hulumtimit do të jetë edhe evaluimi i zgjedhjes së propozuar për atë se sa aplikimi i teknologjisë mobile do të mund të ndikonte në eficientën e institutit për të kryer aktivitetet nga fushëveprimtaria e tyre.

### **Kërkohet:**

1. Zhvillimi i disa sesioneve me hulumtuesit e IKShP në mënyrë që të identifikohen dhe prioritetizohen kërkesat për një sistem të tillë (ang. *requirement elicitation*).
2. Të bëhet një studim i literaturës aktuale (ang. *state of the art*) në lidhje me zbatimin e sistemeve të TI-së në fushën e shëndetit publik. Po ashtu duhet të bëhet hulumtimi i zgjedhjeve aktuale me kod burim të hapur (ang. *open source*) që mund të përdoren pjesërisht apo në tërësi për implementimin e sistemit.
3. Të zhvillohet aplikacioni mobil që do të ketë një komponentë në Ueb në prapavijë (ang. *web backend*) për mbledhjen e të dhënave, processimin e tyre, si dhe përgaditjet për vizualizim. Zgjedhja e teknologjisë varet prej kandidatit në bashkëpunim me mentorin. Njohuria e programimit mobil (native, web apo hibrid), web programimi, si dhe përvoja në përdorimin e web shërbimeve të ndryshme (API) do të jetë përparësi.
4. Pas implementimit të prototipit të sistemit, të zhvillohet validimi i zgjedhjes së propozuar, si dhe evaluimi i potencialit të sistemit për rritjen e eficientës në punën e institutit.

### **Për informata më të detajuara, studenti të kontaktoj:**

FIEK: Prof. Dr. Lule Ahmedi ([lule.ahmedi@uni-pr.edu](mailto:lule.ahmedi@uni-pr.edu)), ose

IKShP: Dafina Gexha Bunjaku ([dafinagexha@gmail.com](mailto:dafinagexha@gmail.com)),

Lnu: Dr. Arianit Kurti ([arianit.kurti@lnu.se](mailto:arianit.kurti@lnu.se))